



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:180620

Datë: 27.01.2023

Numri i dokumentit: 03911684

C.nr.1025/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtarës Elvira Emini gjyqtare individuale, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses Q. Q. nga fshati K. K.Lipjan, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Arif Hasi av. nga Gllogoci, kundër të paditurës K. L.-D. K. A., me objekt të çështjes kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë punës dhe të shpenzimeve të udhëtimit vlera e kontestit 2,941-€, jashtë seancës gjyqësore, me dt.17.01.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET kërkesëpadia e precizuar e paditëses Q. Q. nga fshati K. K.Lipjan, si e **BAZUAR**, dhe **DETYROHET** e paditura K. L.-D. K. A., që paditëses në emër të shpenzimeve të ushqimit për periudhën 18.04.2017 e deri me dt. 19.04.2022, si mësimdhënëse pranë SH.F.M.U.“K. D.” në fshatin K. K. Lipjan, për 865 ditë pune, në vlerë prej 1,730-€, si dhe shpenzimet e udhëtimit nga 1.40-€ në ditë për të njëjtën periudhë, në shumën prej 1,211-€, të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dt. 17.01.2023 si datë e marrjes së aktgjykimit e deri te pagesa definitive, si dhe për shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 248.00-€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.DETYROHET paditësja, që kësaj gjykate, në emër të diferencës të taksës gjyqësore për padi, t'ia kompensojë shumën prej **20-€** në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Arsyetim

Çështja gjyqësore

Paditësja Q. Q. nga fshati K. K.Lipjan, përmes të autorizuarit Arif Hasi av. nga Gllogoci, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës K. L.-D. K. A., me objekt të çështjes Kompensimin e ushqimit gjatë punës dhe të udhëtimit.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Në padi I autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësjë tek e paditura punon në SH.F.M.U. "K. D." në fshatin K. K.Lipjan që nga dt.10.03.2019, ku ende vazhdon të punojë, dhe edhe përkundër kërkesës së parashtruar pranë të paditurës që paditëses t'i paguhen shpenzimet e shujtës ditore konform nenit 35 par.7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit e paditura këto shpenzime nuk ia ka paguar paditësjë. Me parashtruesen me shkrim të dates 06.06.2022 I njëjti e ka precizuar lartësinë e kërkesëpadisë, duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë punës t'ia paguaj shumën prej 1,730-€, ndërsa në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, paditëses t'ia paguaj shumën prej 1,211-€, me kamatë prej 8% nga dita e ngritjes së padisë e deri tek pagesa definitive, të gjitha në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e precizuar të paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas TAOK-së për aq sa do të shkaktohen.

E paditura në të përgjigjur në padi, e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, mbi arsyetimin se sipas kontratës së punës me nr.04-112-813/2455 të dt.10.03.2019, askund nuk iu ceket se punëtori e gëzon të drejtën për kompensim të shujtës të cilën kontratë paditësjë e ka nënshkruar dhe është pajtuar me të gjitha kushtet e kontratës si dhe për detyrat dhe obligimet që i ka, andaj me dëshirë e ka nënshkruar dhe ka konsideruar se nuk e gëzon të drejtën të cilën e kërkon, gjithashtu sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës askund nuk iu ceket se punëtorëve të arsimit iu takojnë kompensimet e tilla, prandaj ka shtuar se kërkesës i mungon baza juridike. Tutje ka theksuar se Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësjë, nuk ka fuqi ligjore për t'u zbatuar nga shkaku se është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe e njëjta vlen vetëm për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin persipër detyrimet e caktura me marrëveshje të tilla Kolektive, dhe meqenëse e paditura nuk është nënshkruese e Kontrates Kolektive të dt. 18.04.2017, por nënshkruese e saj është Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në njerën anë dhe në anën tjetër është SBASHK-u, konsideron se e paditura nuk ka obligime ndaj paditëses, dhe se MASHT nuk ka bërë harmonizimin e saj me Ministrinë e Financave që të paditurës me Qarkore Buxhetore t'i lejohet ngritja e tavanit të pagave në mënyrë që të planifikojnë edhe pagesat shtesë për stafin arsimor. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Mëtutje ka shtuar se nuk është kontestuese se paditësjë është në mardhënie pune tek e paditura. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat dhe gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata mori aktgjykim, pa mbajtur seancë për shqyrtim kryesor, dhe atë konform nenit 398 të LPK-së, këtë për faktin se e paditura, në përgjigje në padi të ushtruar në këtë gjykatë me dt.14.06.2021, nuk e ka kontestuar e as nuk i ka pohuar faktet e theksuara në padi, ndërsa bashkë me padi paditësjë ka paraqitur prova mbi bazën e të cilave mund të vendoset në mënyrë meritore në këtë çështje juridike kontestimore.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, si dhe në parashtruesën për rregullimin e kërkesëpadisë, gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësjë me të paditurën kanë lidhur kontratë pune me datën 10.03.2019 për çmimin e pagës bazë në shumë prej 421.20-€, fakt ky që vërtetohet edhe nga kontrata e cila gjendet në shkresat e lëndës e që evidentohet me nr. të protokollit 04-112-813/2455 të dt.10.03.2019.

Gjykata i ka pranuar si fakte vendimtare për aprovimin e kërkesëpadisë ekzistimin e marrëdhënies kontraktuale për punësimin e punëmarrësit në këtë rast paditëses, kohëzgjatjen e saj dhe çmimin e pagës bazë, prej nga rezulton se lartësia e kërkesëpadisë është në përputhje me shumën e kërkuar.

Kundërshtimin e të paditurës se padia është pa bazë ligjore, gjykata e ka vlerësuar si të parëndësishëm për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestimore, nga fakti se e paditura nuk e konteston ekzistimin e kontratës së punës, por ka konsideruar që me Ligjin e Punës Nr.03/L-212, nuk janë paraparë të drejtat të cilat i kërkon paditësja, pasi që shpërblimet e kërkuara me padi janë të parapara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Nga kërkesa e dt 20.01.2020 me numër 4-120-3735, u vërtetua se i autorizuari i paditëses me dt. 20.01.2020, përmes kësaj shkrese i është drejtuar të paditurës për pagesën e shujtës ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe atë conform nenit 35 par. 2 pika 5 dhe 7 të KKAK-së të dt. 18.04.2017.

Nga kontrata e punës nr. 04-112-813/2455 të dt.10.03.2019, vërtetohet se paditësja tek e paditura në SH.F.M.U. "Katër Dëshmorët" në fshatin Krojmir K.Lipjan, ka qenë në mardhënie pune në kohë të pacaktuar në vendin e punës mësimdhënëse, me page bazë në lartësi prej 421.20-€.

Nga Pasqyra e llogarisë bankare e periudhës së dt. 01.09.2019-10.12.2019, u vërtetua se paga e paditëses është transferuar nga thesari i Ministrisë së Financave të RK-së në shumën R. në shumën prej 435.40-€.

Nga vërtetimi i ditëve të pranisë në punë të paditëses me nr.850 i datës 19.04.2022 u vërtetua se paditësja në këtë shkollë nga data 18.04.2017 deri me dt. 19.04.2022, ka gjithsej 865 ditë efektive pune.

Nga vërtetimi i lëshuar, nga Kompania Transportuese NTT "E.", u vërtetua se paditësja Q. Q. është udhëtare e kësaj Kompanie Transportuese në relacionin L.-K. dhe anasjelltas, e cila udhëton me këtë Kompani nga dt. 18.04.2017 e deri me dt.19.04.2022, dhe çmimi i biletës për një relacion është 1-€, ndërsa çmimi i biletës kthyesë për këtë destinacion është 2 euro.

Baza Ligjore

Me dispozitën e nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e cila ka hyrë në fuqi me dt. 18.04.2017, parashihet se dispozitat e kesaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha insitucionet publike dhe private të Arsimit parauniversitar (para shkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, Shkolla Speciale e Qendra të Kompetencës) dhe Institucione të Arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtar të SBASHK-ut, dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit ne sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD te Universiteteve e institucioneve te arsimit te larte, MASHT-in etj) ne sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private ne mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Me dispozitën e nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.2056 te dt. 18.04.2017, parashihet se punëtorët anëtar të SBASHK-ut punonjesit arsimor kompensohen për shpenzimet e udhëtimit prej 70% te çmimit të biletës, shpenzimet e ushqimit me nga 2 euro për një ditë pune, 75% per 20 vite pervoje pune, nje page baze per 30 vite pervoje pune dhe 150% per 40 vite pervoje pune, shperblim ky i cili paguhet me 7 mars te ç'do viti.

Me dispozitën e nenit 49 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, parashihet se kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët nënshkruese, përkatësisht kjo kontratë ka hyrë në fuqi me dt. 18.04.2017.

Me nenin 3 par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihet “Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”.

Me nenin 5 par. 1 të Ligjit të Punës është e paraparë “Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi”.

Gjykata konstaton se trajtimi i pabarabartë i të punësuarit në vendet e tyre në punë apo një grup i caktuar punëtoresh në një ndërmarrje apo organizatë punuese, si dhe mos realizimi i të drejtave të punësuarve në lidhje me punën e tyre, konsiderohet diskriminim në punë. Andaj ky fakt gjen zbatim në pikën 1.12 të nenit 14 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut e cila ka hyrë në fuqi me dt. 03.09.1953.

Vlerësimi përfundimtar I gjykatës

Mbi gjendjen faktike të vërtetuar, nga provat e administruara si me lartë, te cilave gjykata u'a fali besimin dhe fakteve te pakontestueshme në mes palëve, gjykata zbatoi dispozitat e lartpërmendura të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditëses për pagesën e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, është e bazuar, për qka edhe e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësinë e kërkespadiës, gjykata e caktoi duke pasur parasysh kërkesën e paditëses sipas llogaritjes nga 2 euro për një dite pune duke aprovuar shumën e kërkuar prej 1,730-€, në emër të shpenzimeve të ushqimit, dhe kërkesën e paditëses sipas llogaritjes nga 1.40-€ për një ditë udhëtimi me biletë kthyesë shumën prej 1,211-€ duke llogaritur nga 70% të çmimit të biletës së udhëtimit per 865 dite pune.

Gjykata, me rastin e aplikimit te kamatës ligjore, iu referua nenit 382, par.1 dhe 2 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, në të cilën parashihet “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*, ndërsa në par.2 të të njëjtit nen parashihet “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”, poashtu sa i përket afatit të rrjedhjes se kamatëvonesës, gjykata iu referua aktgjykimit te Gjykatës Supreme të Kosovës **Rev.nr. 284/2019, dt: 07.10.2019**, ku përcaktohet se rrjedhja e kamatëvonesës për detyrimet ne te holla, përcaktohet nga data e nxjerrjes së vendimit të shkallës se parë.

Gjykata i vlerësoi kundërshtimet e palës së paditur, se paditëses nuk i takojnë shpenzimet e ushqimit dhe të udhëtimit me arsyetimin se paditësja nuk është anëtare e SBASHK-ut, se kontrata kolektive paraqet një marrëdhënie kontraktuale në mes të MASHT-it dhe SBASHK-ut për anëtarët e saj dhe dispozitat e kësaj kontrate vlejné për anëtarët e SBASHK-ut, për anëtarët

e saj andaj ata që nuk janë anëtar të SBASHK-ut si rasti i paditëses nuk i takojnë këto të drejta, mirëpo konstatoi se e paditura nuk ka prezantuar asnjë prove relevante, me çka do të argumentonte të kundërtën nga ajo çka pretendon paditësja, andaj të njëjtave nuk ua fali besimin nga se me provat e administruara u vërtetua në mënyrë të padyshimtë, se paditësja ka mbi 28 vite përvojë pune në shkollën perkatëse me të cilën menaxhon e paditura, si punëtor i të paditurës si punëdhënë, ndërsa fakti se paditësi nuk është anëtar i SBASHK-ut nuk e përjashton të njëjtin në realizimin etë drejtave për kompensimin e shujtës ditore dhe shpenzimet e udhëtimit, dhe një e drejtë e tillë për pagesën e shujtës ditore dhe shpenzimet e udhëtimit, parashihet me Marreveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe me kontraten kolektive te arsimit parauniversitar, të permendura si më lartë, ku decidivisht është paraparë e drejta e punëtorit për kompensimin e shujtës ditore dhe për shpenzimet e udhëtimit më konkretisht neni 35 par. 5 dhe 7 I KKAK-së, marreveshje dhe kontrate kjo e cila është obligative edhe për të paditurën si punëdhënëse. Andaj gjykata vlerëson e njëjta ka hyrë në raport detyrimor me paditësen, në të cilin raport paditësja e ka cilësinë e kreditores, kurse e paditura e ka cilësinë e debitorit.

Gjykata vlerëson se e paditura nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë duke pretenduar se një kompensim i tillë nuk është paraparë me Ligjin e Punës, apo se nuk është nënshkruese e kontratës kolektive, ngase se i njëjti është paraparë me dispozitat e KKAK-së, nënshkruese e të cilës është edhe MASHT-i, e poashtu theksimi në fjalë i të paditurës nuk e liron nga obligimi për pagesën e shumave si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sepse kontratat e nënshkruara në mes të palëve kanë bazën ligjore në Ligjin për Mardhënjet e Detyrimeve, dispozitat perkatëse të këtij ligji neni 7 që e rregullojnë materien e qështjes së kontratës, kurse konform neni 8 të Ligjit për Mardhënjeve të Detyrimeve Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, iu referua neni 452, par.1 të LPK-së, dhe të autorizuarit të paditësit ia pranoi të drejtën e pagesës së shpenzimeve procedurale sipas pikës II të dispozitivit, në të cilën përcaktohet “*Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore*”, ndërsa lartësinë e tyre e përcaktoi në përputhje me Rregulloren e Tarifës së Avokatëve të Kosovës e vitit 2017, gjegjësisht nr. tarifor 6 dhe 7, ndërsa për taksë gjyqësore iu referua Udhëzimit Administrativ për Taksa Gjyqësore nr. 01/2017, gjegjësisht neni 12, par.1 të këtij udhëzimi ku përcaktohet lartësia e taksës gjyqësore, ashtu që e detyroi të paditurën që paditëses t'ia kompensojë në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 248.00 -€, dhe atë, për padi shumë prej 104-€, për precizim të kërkespadsisë shumë prej 104-€, dhe në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 40-€, shpenzime këto të cilat gjykata ia pranoi paditëses, të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e kësaj çështje në gjyq.

Nga të lartshënuarat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË LIPJAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1025/20 me dt.17.01.2023

GJYQTARJA
Elvira Emini

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj ankesë, në afatin prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e dorëzimit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e cila ushtrohet nëpërmes të kësaj gjykate.